



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2509/ 5 prot.

Datë 16.10.2025

V E N D I M
Nr. 1454/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.10.2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankess së operatorit ekonomik “Rikon-Al” SHPK, për procedurën e prokurimit *E hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-60680-09-09-2025, me objekt “Shërbim i Printimit dhe Fotokopjimit” me fond limit: 7,000,000 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “Erisoni Company” ShPK me Nipt, K92006501A Adresa: Lagjja 6, Rr. “Shoqëria Bashkimi”, Durrës.

Operatori ekonomik “Rikon-Al” SHPK me Nipt, L22119010H dhe adresë: Rr. “Ismail Qemali”, Nd.40, H 28, 1050, Yzberisht, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.
.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar.

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.09.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit *“E hapur e thjeshtuar”*, me Nr. 60680-09-09-2025, me objekt *“Shërbim i Printimit dhe Fotokopjimit”* me fond limit: 7,000,000 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5810 datë 16/09/2025 dhe me nr. 2509/2025 prot., datë 17/09/2025 nga operatori ekonomik *“Erisoni Company”* SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.2.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.3. Autoriteti kontraktor me shkresat në sistem me nr. 3752/37 prot, datë 22.09.2025 protokolluar me tonën me nr. 2509/1, datë 23.09.2025, dhe me nr. 2509/2 prot., datë 24.09.2025 me objekt “Informacion” ka përcjellë Vendimin e KSHA-së mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Erisoni Company” SHPK duke mos pranuar pretendimet e ngritura.

II.4 Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5814 datë 16/09/2025 dhe me nr. 2513/2025 prot., datë 17/09/2025 nga operatori ekonomik “Rikon-AL” SHPK për procedurën e prokurimit objekt ankimi duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4 Me shkresën me nr. 3752/36 prot, datë 22.09.2025 protokolluar me tonën me nr. 2513/1, datë 22.09.2025, si edhe ardhur me postë protokolluar me nr. 2513/2, datë 24.09.2025 me objekt “Informacion”, Autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Rikon-AL” SHPK duke pranuar pjesërisht pretendimet e ngritura.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rikon-AL” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket:

Pika 2.3.2.

AK në DST ka kërkuar si vijon: “Të paktën 2 (dy) specialistë/teknikë me diploma Inxhinierie/IT nga institucione arsimore vendase apo te huaja”. Ankesa 2: Ky kriter në gjykimin tonë, është një kriter i keqvendosur, i tepruar, jo proporcional dhe kufizues për sa i përket konkurrencës. Ju lutem, njihuni me faktet dhe argumentat tona, si më poshtë: Nga kriteri, vërejmë që janë vendosur një sasi e madhe inxhinierësh, duke filluar që nga inxhinier elektronik apo IT. Kjo sasi punonjës me këto kualifikime universitare tepër specifike, nuk janë aspak të përshtatshëm për këtë procedurë prokurimi. Risjellim në vëmendje që procedura e prokurimit është ofrimi dhe kontraktimi i një shërbimi printimi, pra lënda e parë, pajisjet, pjesët e konsumueshme, mirëmbajtja dhe risku transferohet tek OE, dhe AK nga ana tjetër garanton shërbim me SLA

të lartë dhe paguan për çdo fletë që printohet. Logjikisht, kjo kërkon pajisjet, vënien në punë, lidhjen me rrjetin dhe asgjë më shumë. Nuk është nevoja të disponohen aq shumë inxhinierë, të cilët duke i parë në pamje të parë, duket sikur po ngrihet nga fillimi i gjithë rrjeti elektronik i SHRUK Durrës. Nëse i referohemi argumentimit të kriterëve të paraqitur nga AK në formularin e argumentimit, ai është si vijon: “Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: a) Të paktën 1 (një) Inxhinier Elektronik për të instaluar dhe konfiguruar pajisje multifunksionale (printer/fotokopje skaner) dhe përshtatja me rrjetin ekzistues të AK. b) Të paktën 1 (një) specialist/teknik me diploma Inxhinierie/IT për të instaluar dhe konfiguruar pajisje multifunksionale, evidentuar, interpretuar problematikat e mundshme gjatë përdorimit të pajisjes dhe zgjidhja e problemit. c) Të paktën 1 (një) specialist/teknik me diploma Inxhinierie/IT për të instaluar dhe konfiguruar pajisje multifunksionale me software përkatës. Të lexojë dhe interpretojë softwarein.”. 1. AK kërkon që OE të disponojë inxhinierë apo teknik me diplomë inxhinierie?

Kërkojmë:

Kërkesa: “Të paktën 2 (dy) specialistë/teknikë me diploma Inxhinierie/IT nga institucione arsimore vendase apo të huaja”.

TË MODIFIKOHET DHE TË BËHET:

“Të paktën 2 (dy) teknikë të certifikuar për pajisjet, me të cilat do të realizohet shërbimi i printimit ose marka ekuivalente”.

III.1.1.- Autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së ka vendosur të pranojë këtë pretendim për **pikën 2.3.2. si vijon:**

[...] KSHA mendon se kërkesa nuk është në proporcion, referuar VKM-së nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve të rishikuar LKP-së”, kriteri është i ekzagjeruar dhe duhet të ndryshohet si më poshtë:

Bëhet:

“të paktën 1(një) Inxhinier elektronik ose IT me diploma inxhinierie nga institucione vendase apo të huaja”.

“të paktën 2(dy) specialistë teknikë të certifikuar për pajisjet, me të cilat do të realizohet shërbimi i printimit ose marka ekuivalente” .

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pikat 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se:

1. “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar nga autoriteti kontraktor, Komisioni konstaton, se ka pranuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Rikon-Al” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. 60680-09-09-2025, me objekt “Shërbim i Printimit dhe Fotokopjimit” me fond limit: 7,000,000 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues.

Komisioni do të vijojë me shqyrtimin në themel të pretendimeve të tjera të ankesës.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rikon-Al” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket: *Pika 1: AK në DST ka kërkuar si vijon: “2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”.*

AK në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, konkretisht tek 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar AK ka vendosur kriterë të pabazuara në ligj, konkretisht jo konform llojit të procedurës së prokurimit dhe kufizuese për konkurrencën e lirë në procedurat e prokurimit publik duke iu referuar fondit limit është përcaktuar se lloji i procedurës së prokurimit është “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, ndërkohë vetë AK nuk i është referuar llojit të procedurës në fjalë.

Kërkojmë të hiqet Kriteri 2.2.2. i Kapacitetit ekonomik dhe Financiar.

III.2.1 Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” ka parashikuar si më poshtë:

Kapaciteti ekonomik dhe financiar,

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023 dhe 2024** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të fondit limit të kontratës që prokurohet.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, Argumentuar:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 9, të Ligjit Nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

III.2.2. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në nenin 77, pikat 1,3 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1 Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.2.3. Referuar Nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 1 dhe pika 4, të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikon

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Referuar Nenit 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” pika 4 i VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikon:

[...]Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave...[...]

III.2.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin/ apo vendosjen e kriterëve ligjvënës i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) *në përpyesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe* (ii) *jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.*

Në rastin konkret, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë sipas pikës 2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Gjithashtu Komisioni konstatoi se autoriteti kontraktor ka kërkuar paraqitje njëkohësisht, **të xhirove vjetore në pikën 2.2.1**, për procedurën e hapur e thjeshtuar, si është procedura në fjalë, kur legjislacioni parashikon që: *“Autoritet Kontraktore të formulojnë kërkesa minimale në proporcion me llojin e procedurave, fondin limit dhe sasinë e mallrave për prokurim”*.

Komisioni vëren, se synimi bazë i autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi është sigurimi i mallrave objekt prokurimi në përputhje me specifikimet teknike dhe realizimin me sukses të kontratës. Referuar testit të proporcionalitetit Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se këto kërkesa nuk duhet të jenë kufizuese dhe se kriteri i vendosur nuk është në proporcion me natyrën dhe objektin e kontratës, ndaj dhe autoriteti kontraktor duhet të kryejë modifikimin të DST me qëllim për të zgjeruar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor me kërkesa të tilla ndikon në uljen e konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke kufizuar pjesëmarrjen e tyre në këtë procedurë prokurimi, duke mos u dhënë mundësi operatorëve të tjerë ekonomikë të cilët mund zotërojnë kapacitetet për pjesëmarrje në procedurën objekt ankimi.

Komisioni i Prokurimit Publik, për arsye të mësipërme, gjykon se autoriteti kontraktor, duhet të marrë masa për të hequr kriterin 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si një kërkesë e tepërt, pasi plotësimi i kapaciteteve ekonomiko financiare mund të përmbushet me paraqitjen e vërtetimit të xhirove vjetore, të realizuar nga operatorët ekonomikë kërkuar nga AK me kriterin 2.2.1.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rikon-Al” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket:

Pika 2.4.2

AK në DST ka kërkuar “Për Letër A4+A3 79.5-80.5 g/m², OE duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/skedën teknike, në të cilën të gjejnë pasqyrim specifikimet teknike të kërkuara me produktet e ofruara. Katalogu/ skeda teknike duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Kërkesa për paraqitjen e katalogut për letrën, është një kërkesë e tepruar dhe nuk i shërben qëllimit të procedurës së prokurimit publik që është realizimi i shërbimit të printimit të institucionit.

Risjellim në vëmendje AK që objekti i procedurës nuk është furnizimi me letër apo me konsumabla të pajisjeve të printimit, por realizimi i shërbimit të printimit, ku OE do të paguhet për çdo fije letre të printuar. Gjithashtu nuk i shërben as procedurës së prokurimit, por shërben vetëm për kufizimin e konkurrencës duke e orientuar fituesin e procedurës së prokurimit tek operatori i cili e ka fituar këtë procedurë vitet e fundit.

Kërkesa: “Për Letër A4+A3 79.5-80.5 g/m², operatori ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/skedën teknike, në të cilën të gjejnë pasqyrim specifikimet teknike të kërkuara me produktet e ofruara. Katalogu/ skeda teknike duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, TË HIQET.

III.3.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, 2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim, ka kërkuar kriterin:

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose broshurë për mallin, letrën dhe softwar-in që oferton. Katalogu ose broshura duhet të jenë të përkthyer, noterizuara si dhe të markuara për verifikimin e specifikimeve teknike të pajisjeve si më poshtë:

- Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A3 me shpejtesi printimi ≤ 45
- Fotokopje/Printer/Skaner A3 Bardh e zi me shpejtesi printimi ≤ 55
- Fotokopje/Printer/Skaner(Bardh/Zi) A4 me shpejtesi printimi ≤ 55
- Software për leximin, menaxhimin, raportimin sipas userave apo departamenteve, në lidhje me faqet e printuara, fotokopjuara,

Për Letër A4+A3 79.5-80.5 g/m², operatori ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/skedën teknike, në të cilën të gjejnë pasqyrim specifikimet teknike të kërkuara me produktet e ofruara. Katalogu/ skeda teknike duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

OE duhet të deklarojë adresat, nr. tel, email, emër mbiemër të personave të kontaktit në kompaninë prodhuese apo distributore, për verifikimin e të dhënave.

Argumentuar:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht.... Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

III.3.2. Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti.

III.3.3. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret

specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, duke mos i tejkaluar kufijtë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.3.5. Referuar objektit të prokurimit “Shërbim printimi” si edhe referuar kriterit të vendosur 2.4.2, mbi paraqitjen e [...] *Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose broshurë për mallin, letrën dhe softwar-in që oferton. Katalogu ose broshura duhet të jenë të përkthyer, noterizuar si dhe të markuara për verifikimin e specifikimeve teknike të pajisjeve [...]*, Komisioni vlerëson kriterin objekt ankimi jo në proporcional me objektin e prokurimit. Me të drejtë ankimuesi ngre pretendime [...] *kërkesë e tepruar aspak proporcionale dhe nuk i shërben qëllimit të procedurës së prokurimit....[...]* të cilat rezultojnë të argumentuar qartë nga operatori ekonomik dhe që duhet të hiqet, pasi nuk i shërben objektit të prokurimit. AK kërkon katalog/broshura për mallrat dhe aparaturat të cilat nuk janë objekt *blerje pajisje por shërbim printimi*, ku operatori ekonomik është subjekti i cili ofron pajisjet e tij, në përputhje me specifikimet teknike, për të kryer një shërbim të kërkuar.

Komisioni i Prokurimit Publik në analizë të dokumenteve sipërcituar vlerëson, se kërkesa e mësipërme është e ekzagjeruar dhe në kundërshtim me parimet dhe rregullat e prokurimit publik dhe parimin e proporcionalitetit.

Komisioni gjykon se është përgjegjësi e operatorit ekonomik të furnizojë me pajisje funksionale, në përputhje me specifikimet teknike, si edhe t'i mirëmbajë ato për periudhën e realizimit të kontratës së shërbimit të kërkuar në përputhje me kërkesat e AK-së.

Nga ana tjetër autoriteti kontraktor ka në dispozicion momentin procedural të zbatimit të kontratës, ku mund të verifikojë pajisjet, funksionimin e tyre apo edhe mallrat, si letra dhe pjesët e tjera që do të sigurojë operatori ekonomik dhe t'i vlerësojë në përputhje me specifikimet teknike të vendosura në DST. Në rast mospërputhje operatori ekonomik, mban përgjegjësi dhe autoriteti zbaton penalitete në përputhje me kontratën e shërbimit.

Referuar sa më sipër Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të heqë kriterin 2.4.2 si kriter i tepërt, diskriminues e joproporcional me objektin e prokurimit.

Përsa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rikon-Al” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket:

Pika 2.4.4

“2.4.4 Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar, i lëshuar për operatorin ekonomik ofertues, i cili duhet të përmbajë dhënien e të drejtave për furnizimin e mallrave të Konsumit objekt i prokurimit. Në rastin e dokumenteve të lëshuara nga Distributor i Autorizuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë detyrimitisht edhe aktin e caktimit të distributorit nga prodhuesi përkatës. Autorizimi duhet në formën origjinale ose kopje e njehsuar me origjinalin, i përkthyer dhe i noteruar. Autorizimi i prodhuesit/distributorit duhet të ketë të përcaktuar adresën e saktë të firmës që e ka lëshuar këtë dokument, adresën e postës elektronike, nënshkrimin dhe emrin e zyrtarit përgjegjës dhe vulën e shoqërisë. Në rast se Autorizimi nuk i përmban këto të dhëna dokumenti do të konsiderohet i pavlefshëm për qëllim kualifikimi”. Ankesa 4: Vendosjen e kërkesës për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit për të gjitha pjesët dhe mallrat dhe pjesët e konsumit, e gjykojmë si kërkesë të tepruar, aspak proporcionale dhe që nuk e shërben zbatimin të parimit të konkurrueshmërisë dhe pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik. Vendosja e kësaj kërkesë, sipas gjykimit tonë, nuk është proporcionale me procedurën e prokurimit, nuk i shërben qëllimit të procedurës së prokurimit dhe është tërësisht e pa argumentuar. Me sa disponojmë informacion, asnjë operator shqiptar nuk është prodhues i pjesëve të pajisjeve me të cilat do të realizohet objekti i prokurimit. Edhe nëse në këtë procedurë prokurimi, do të ofertojë vetë prodhuesi, atëherë nuk do të ketë nevojë për autorizim prodhuesi. Në rast, se OE nuk është prodhues, por paraqet autorizim prodhuesi, ky autorizim është një term i cili ka të bëjë me marrëdhënien ekonomiko-financiare që ka një rishitës me distributorin dhe prodhuesin. Pra është një dokument i cili mundësohet pasi kërkohet kuotim për pajisjet objekt prokurimi. Autorizimi i prodhuesit nuk garanton që pajisjet janë origjinale, cilësore apo konform kërkesave të Autoritetit Kontraktor. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit është një dokument që vërteton një ekzistencën e një marrëdhënie tregtare, jo një dokument që vërteton që mallrat janë konform specifikimeve, origjinale apo cilësore. Në rastin e kësaj procedure objekt ankimi, autorizimi i prodhuesit nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, pasi nuk kemi të bëjmë me lëvrin, por me një shërbim printimi. APP, në rekomandimet e herëpashershme për Autoritetet Kontraktore, e ka vendosur theksin të proporcionaliteti në hartimin e kriterëve dhe kërkesave për kualifikim dhe na rastin e kërkesës për autorizim prodhuesi/distributori, konkretisht në Rekomandimin Nr.7998 datë 24.12.2021, APP rekomandon se: AK kërkojnë në procedurat e prokurimit me objekt në fushën e teknologjisë së informacionit, kërkesa për partneritet me prodhuesin (i cili mund të jetë in niveleve të ndryshme-Silver, Gold, etj). Partneriteti me prodhuesin përcaktohet në bazë të sasisë së mallit apo shërbimeve të blera nga operatori ekonomik, pra sipas nivelit të bashkëpunimit në terma monetarë me prodhuesin dhe nuk është indikator i drejtpërdrejtë i aftësisë teknike të operatorit ekonomik. Për rrjedhojë, rekomandojmë që të shmangen kërkesa të tilla, të cilat nuk përcaktojnë drejtpërdrejtë aftësinë teknike të operatorëve ekonomikë, për realizimin e kontratave.

Kërkojmë që Kriteri 2.4.4. të Modifikohet.

TË BËHET:

2.4.4 *Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar, i lëshuar për operatorin ekonomik ofertues, i cili duhet të përmbajë dhënien e të drejtave për ofrimin e shërbimit të printimit objekt prokurimi.*

Në rastin e dokumenteve të lëshuara nga Distributor i Autorizuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë detyrimisht edhe aktin e caktimit të distributorit nga prodhuesi përkatës.

Autorizimi duhet në formën origjinale ose kopje e njehsuar me origjinalin, i përkthyer dhe i noteruar.

Autorizimi i prodhuesit/distributorit duhet të ketë të përcaktuar adresën e saktë të firmës që e ka lëshuar këtë dokument, adresën e postës elektronike, nënshkrimin dhe emrin e zyrtarit përgjegjës dhe vulën e shoqërisë.

III.4.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, 2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim, ka kërkuar kriterin:

2.4.4 Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar, i lëshuar për operatorin ekonomik ofertues, i cili duhet të përmbajë dhënien e të drejtave për furnizimin e mallrave të Konsumit objekt i prokurimit.

Në rastin e dokumenteve të lëshuara nga Distributor i Autorizuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë detyrimisht edhe aktin e caktimit të distributorit nga prodhuesi përkatës.

Autorizimi duhet në formën origjinal ose kopje e njehsuar me origjinalin, i përkthyer dhe i noteruar.

Autorizimi i prodhuesit/distributorit duhet të ketë të përcaktuar adresën e saktë të firmës që e ka lëshuar këtë dokument, adresën e postës elektronike, nënshkrimin dhe emrin e zyrtarit përgjegjës dhe vulën e shoqërisë.

Në rast se Autorizimi nuk i përmban këto të dhëna dokumenti do të konsiderohet i pavlefshëm për qëllim kualifikimi”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht.... Kjo kërkesë i garanton autoritetit kontraktor që, përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, operatori ekonomik është i autorizuar nga distributori/prodhuesi për të furnizuar autoritetin kontraktor me mallrat e konsumit duke u siguruar në këto mënyra që në asnjë moment të mos ketë ndërprerje të shërbimit për shkak të mungesës të mallrave konsumit dhe duke garantuar vijueshmërinë dhe cilësinë e shërbimit të kontraktuar.

III.4.2. Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti.

III.4.3. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, duke mos i tejkaluar kufijtë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.4.5. Referuar objektit të prokurimit “Shërbim printimi” si edhe referuar kriterit të vendosur 2.4.4, mbi paraqitjen e [...] *Autorizim nga Prodhuuesi ose Distributori i autorizuar, i lëshuar për operatorin ekonomik ofertues, i cili duhet të përmbajë dhënien e te drejtave për furnizimin e mallrave të Konsumit objekt i prokurimit.* [...], Komisioni vlerëson kriterin objekt ankimi jo në proporcional me objektin e prokurimit. Me të drejtë ankimuesi ngre pretendime [...] *kërkesë e tepruar aspak proporcionale dhe nuk i shërben qëllimit të procedurës së prokurimit....* [...] të cilat rezultojnë të argumentuar qartë nga operatori ekonomik dhe që duhet të hiqet pasi nuk i shërben objektit të prokurimit.

AK kërkon katalog/broshura për mallrat dhe aparaturat të cilat nuk janë objekt *blerje pajisje por shërbim printimi*, ku operatori ekonomik është subjekti i cili ofron pajisjet e tij, në përputhje me specifikimet teknike, për të kryer një shërbim të kërkuar.

Komisioni i Prokurimit Publik në analizë të dokumeteve sipërcituar vlerëson, se kërkesa e mësipërme është e ekzagjeruar dhe në kundërshtim me parimet dhe rregullat e prokurimit publik dhe parimin e proporcionalitetit.

Komisioni gjykon se është përgjegjësi e operatorit ekonomik të furnizojë me pajisje funksionale, në përputhje me specifikimet teknike, si edhe ti mirëmbajë ato për periudhën e realizimit të kontratës së shërbimit të kërkuar, në përputhje me kërkesat e AK-së.

Nga ana tjetër autoriteti kontraktor ka në dispozicion momentin procedural të zbatimit të kontratës, ku mund të verifikojë pajisjet, funksionimin e tyre apo edhe mallrat, si letra dhe pjesë të tjera që do të sigurojë operatori ekonomik dhe t'i vlerësojë në përputhje me specifikimet teknike të vendosura në DST. Në rast mospërputhje operatori ekonomik, mban përgjegjësi dhe autoriteti zbaton penalitete në përputhje me kontratën e shërbimit.

Referuar sa më sipër Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të heqë **kriterin 2.4.4** si kriter i tepërt, diskriminues e joproporcional me objektin e prokurimit si edhe në kuadër të hapjes së konkurrencës.

Përsa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.5. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 6, Specifikime Teknike të Pajisjeve të Kërkuara, ka kërkuar:

23 Fotokopje/Printer/Skaner(Bardh/Zi) A4 për volume të larta pune,

“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner Bardh e zi
Shpejtësia “Kopje/Print për A4	≥ 55 ppm
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity”	≥ 650 fletë
Kapaciteti mbajtes së ADF	≥ 150 fletë

ku në vendosjen e tyre AK thotë se është mbështetur tek AKSHI, ku ndërkohë po t’i referohemi AKSHIT për të njëjtin model nuk rezultojnë të njëjtat specifikime:

Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4”: ≥ 30 ppm

Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity min”: 500 Fletë

Kapaciteti në Dalje “Output Capacity min Standard”: 250 Fletë

Kerkojmë të modifikohen:

Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4”: **≥ 30 ppm**”.

Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity min”: **500 Fletë**

Kapaciteti në Dalje “Output Capacity min Standard”: **250 Fletë**”.

I njëjti argument edhe

5 Fotokopje/Printer/Skaner(Bardh/Zi) A4 për volume te mesme,

“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner Bardh e zi
Shpejtësia “Kopje/Print për A4	≥ 40 ppm
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity”	≥ 650 flete
Kapaciteti mbajtes së ADF	≥ 100 flete

Referuar AKSHI-it per këtë pajisje ka këto parametra:

Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4”: **≥ 20 ppm**

Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity min”: **250 Fletë**

Kapaciteti në Dalje “Output Capacity min Standard”: **100 Flet**

Kërkojmë të modifikohen:

Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4”: **≥ 20 ppm**”.

Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity min: **250 Fletë**

Kapaciteti në Dalje “Output Capacity min Standard: **100 Fletë**.”

III.5.1. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në 13 zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

Neni 36, “Specifikimet teknike” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime,

e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.

III.5.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së Lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, thuhet se: *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/ përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të të orientojnë operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë, që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ushtrojnë të drejtën e ankimit mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110, pika 1 të ligjit nr.162/2020.

III.5.3. Komisioni i Prokurimit Publik referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues, mori në shqyrtim dokumentacionin e tenderit, shtojcën 6, specifikimet teknike të publikuar në SPE si edhe vendimin e KSHA-së me anë të së cilës AK nuk ka pranuar këto pretendime të operatorit ekonomik.

Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim dokumentacionin e tenderit, shtojcën 6, specifikimet teknike të publikuar në SPE si edhe vendimin e KSHA-së ku konstatoi se me anë të së cilës AK nuk ka pranuar këto pretendime të operatorit ekonomik.

Komisioni thekson se autoriteti kontraktor, në hartimin e specifikimeve teknike, duhet të evitojë përcaktimet dhe parametra me vlera fikse ose shumë të larta, në lidhje me funksionet e pajisjeve të sipërcituara, në mënyrë që të mos ketë asnjë element që çon në kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Komisioni gjykon se ankimuesi me të drejtë ngre pretendime mbi modifikime të parametrave, në lidhje me pajisjet e printimit mbi funksionet e pajisjeve dhe sugjeron që ato të jenë në referim të specifikimeve të AKSHI-it. Komisioni, referuar specifikimeve teknike si edhe pretendimet e ngritura në ankesë, gjykon se **Autoriteti kontraktor përsa i përket parametrave të përcaktuara në lidhje me pajisjet e printimit, duhet t'i rishikojë sipas parametrave orientuese të përcaktuara në manualin e specifikimeve teknike të publikuara nga AKSHI**, përsa kohë AK është shprehur në Shtojcë se: *“Specifikimet teknike janë ndërtuar në përputhje me standardet e rekomanduara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), me qëllim që të sigurohet ndërveprueshmëri, siguri dhe përputhshmëri me sistemet ekzistuese të administratës publike”, si edhe me synimin për të hapur mundësinë e ofertimit nga operatorët ekonomikë në kuadër të një pjesëmarrjeje të gjerë dhe konkurruese në këtë procedurë.*

Përsa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Erisoni Company” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket: *[...]Paraqesim ankesën tonë brenda afatit ligjor. Kunder percaktimit te kriterit qe afati i levrimit do jete 15 dite nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës paraqesim argumentin tone si me poshte: Per 50 pajisje afati i levrimit eshte shume i vogel. Kjo bie ndesh me nenin 2 dhe 3 te LPP Qe te nxitet pjesemarrja e cdo operatori ekonomik i interesuar ne kete procedure prokurimi. ne kerkojme qe afati i levrimit te jete 30 dite nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratësKomisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.6.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 6 Formulari i Specifikimeve Teknike ka parashikuar si më poshtë:

“Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a për të realizuar shërbimin e printimit, fotokopjimit, skanimit kërkon këto pajisje sipas specifikimeve të përmendura më poshtë.

Nr.	Përshkrimi	Nj/M	Sasia
1	Fotokopje/Printer/Skaner (me ngjyra) A3	copë	16
2	Fotokopje/Printer/Skaner (Bardh/Zi) A4 për volume të larta pune	copë	23
3	Fotokopje/Printer/Skaner (Bardh/Zi) A4 për volume të mesme pune	copë	5
4	Fotokopje/Printer/Skaner (me ngjyra) A4 për volume të larta pune		2

	Fotokopje/Printer/Skaner (me ngjyra) A4 për volume të mesme pune	copë	2
	Fotokopje/Printer/Skaner (me ngjyra) A4 për volume të ulët pune	copë	2
	Totali pajisjeve		50
	Software për leximin, manaxhimin, raportimin sipas userave apo departamenteve ne lidhje me faqet e printuara, fotokopjuara		1

Shtojca 7. FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: **Afatet e ekzekutimit:**

VOLUMI I PARASHIKUAR PËR PRINTIM DHE FOTOKOPJIM

Numri i printimeve dhe fotokopjimeve parashikohet të jetë 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës:

NR.	PËRSHKRIMI	SASIA E PRINTIMEVE	Çmimi/Njësi
1.	Shërbim printimi A4 bardh/zi	2 800 000	
2.	Shërbim printimi A3 bardh/zi	150 000	
3.	Shërbim printimi A4 me ngjyra	200 000	
4.	Shërbim printimi A3 me ngjyra	50 000	

Afatet e lëvrimeve të pajisjeve: 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga lidhja e kontratës së shërbimit ose nga njoftimi zyrtar që do të japë autoriteti kontraktor për fillimin e shërbimit.

III.6.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit”, 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

III.6.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.6.4. Në rastin konkret referuar pretendimeve të ankimuesit, dokumenteve të procedurës së prokurimit, mbi rishikimin e afatit të lëvrimit të pajisjeve Komisioni gjykon, se periudha e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, nuk është e mjaftueshme për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit, duke pasur parasysh shërbimin që do të realizohe, numrin e pajisjeve që do të vendosen, dhe ambientet e përcaktuara të autoritetit kontraktor.

Afati i ekzekutimit të lëvrimit në rastin konkret, duhet të jetë më i gjatë në përputhje me volumin dhe sasinë e paisjeve, në mënyrë që ofertuesve t'ju lihet koha e nevojshme për të vendosur ato në ambientet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Për rrjedhojë, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë afatin e vendosjes së pajisjeve në ambientet e autoritetit kontraktor, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Erisoni Company” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket:
2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

Të paktën 1 (nje) Inxhinier Elektronik

Të paktën 2 (dy) specialistë/teknikë me diploma Inxhinierie/IT nga institucione arsimore vendase apo te huaja Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: • Kontratat e punës • Diplomat • Listëpagesat për 3 muajt e fundit nga data e publikimit të procedure

III.7.1 Autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së mbi shqyrtimin e pretendimeve të operatorit ekonomik “Rikon-Al” SHPK, në lidhje me modifikime të kriterit 2.3.2 ka vendosur: Të pranojë këtë pretendimin për **pikën 2.3.2. si vijon:**

[...] KSHA mendon se kërkesa e kriterit 2.3.2. nuk është në proporcion, referuar VKM-së nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve të rishikuar LKP-së”, kriteri është i ekzagjeruar dhe duhet të ndryshohet si më poshtë:

Bëhet

“të paktën 1(një) Inxhinier elektronik ose IT me diploma inxhinierie nga institucione vendase apo të huaja”.

“të paktën 2(dy) specialistë teknikë të certifikuar për paisjet me të cilat do të realizohet shërbimi i printimit ose marka ekuivalente” .

III.7.2.Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në 13 zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.7.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik mbi uljen e numrit të punonjësve të kualifikuar, Inxhinierë nga 3 punonjës në 1, Komisioni gjithashtu iu referua Vendimit të KSHA-së mbi modifikim e kriterit, dhe në përfundim gjykon, se me këtë vendim, autoriteti kontraktor ka reduktuar numrin e inxhinierëve nga 3 në 1, si vijon:

Bëhet:

“të paktën 1(një) Inxhinier elektronik ose IT me diploma inxhinierie nga institucione vendase apo të huaja”.

“të paktën 2(dy) specialistë teknikë të certifikuar për paisjet me të cilat do të realizohet shërbimi i printimit ose marka ekuivalente”.

Komisioni gjykon se autoriteti me modifikimin e kryer ka vendosur numër minimal të punonjësve të kualifikuar për kryerjen e shërbimit duke rezultuar në proporcion me objektin e prokurimit, numrin e pajisjeve dhe shërbimet e tjera mbi mirëmbajtjen dhe funksionimin përgjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës.

Përsa më sipër Vendimi i KSHA qëndron.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Erisoni Company” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket:

Kriterit 2.3.3

Kërkesa që ne të kemi në stafin tonë 5 punonjës, 3 specialistë/teknike/inxhinier dhe 2 shoferë është diskriminuese ,nuk është në proporcion me volumin e kontratës që prokurohet. Edhe vetë Ak nuk e ka argumentuar qartë këtë kriter, pse duhen 5 punonjës për këtë procedurë prokurimi, pasi është procedurë “e hapur e thjeshtuar” dhe është mëse i mjaftueshëm 1 punonjës specialist rrjetesh kompjuterike.

Kërkojmë që të modifikohet dhe te bëhet:

Kërkojmë modifikimin e:

Kriterit 2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore **prej minimalisht 5 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Të bëhet: 2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore **prej minimalisht 1 person**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

III.8.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, 2.3.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim, ka kërkuar kriteret:

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

Të paktën 1 (një) Inxhinier Elektronik;

Të paktën 2 (dy) specialistë/teknikë me diploma Inxhinierie/IT nga institucione arsimore vendase apo të huaja;

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës
- Diplomat
- Listëpagesat për 3 muajt e fundit nga data e publikimit të procedurës.

Modifikuar me Vendimin e KSHA-së.

2.3.2.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

Të paktën 1(një) Inxhinier elektronik ose IT me diploma inxhinierie nga institucione vendase apo të huaja”.

Të paktën 2(dy) specialistë teknikë të certifikuar për paisjet me të cilat do të realizohet shërbimi i printimit ose marka ekuivalente”.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 5 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët

ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

III.8.1.1. Autoriteti kontraktor në ProcesVerbalin Mbi Argumentimin e Kritereve për kualifikim dhe specifikimeve teknike, për Kriterin 2.3.3 ka argumentuar si vijon:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

3 (tre) specialistë/teknike/ inxhinier sipas kërkesave në pikën 2.3.2 dhe

2(dy) shoferë që do të kryejnë transportin e pajisjeve artikujve të printerave.

III.8.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin/apo vendosjen e kritereve, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë, se përcaktimi i këtyre kritereve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Në referim të përcaktimit në nenin 40 të VKM 285 datë 19.05.2021, për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor, duhet të kërkojë një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj, dhe kërkesa për personel duhet të jetë gjithashtu e mirëargumentuar, pasi në të kundërt autoritetet përballen me ankesa mbi modifikime të kritereve dhe si rezultat sjellin zvarritje të procedurave.

Në rastin konkret referuar ankesës, me anë të së cilës operatori ekonomik kundërshton përcaktimin 2(dy) shoferë që do të kryejnë transportin e pajisjeve artikujve printera, Komisioni nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës konstatoi, se kjo kërkesë e specifikuar nuk është në Shtojcën 9, Kriteri 2.3.2 apo edhe në Kriterin 2.3.3., por e gjejmë vetëm tek P-V Mbi argumentimin e kritereve, çka ka sjellë konfuzion dhe me të drejtë është bërë shkak për ankesa.

Përsa konstatuar Komisioni gjykon se Autoriteti kontraktor me hartimin e dokumenteve të procedurës nuk ka unifikuar kërkesat në dokumentet objekt ankimi dhe operatori ekonomik me të drejtë e kundërshton atë.

Gjithashtu Komisioni konstaton se Ak ka kërkuar nga operatorët ekonomikë kërkesën **2.4.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër transportin e pajisjeve dhe implementimin pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor brenda afatit të parashikuar, me përmbushjen e së cilës është në përgjegjësinë e tij të transportojë pajisjet e kërkuara.**

Përsa konstatuar më sipër Komisioni gjykon se, kërkesa specifikisht për për 2 punonjës shoferë është e tepërt ndaj duhet të hiqet nga P-V Mbi argumentimin e kritereve për kualifikim, pasi

operatorët ekonomikë marrin përsipër të kryejnë shërbimin e transportit me përmbushjen e kriterit 2.4.3.

Gjithashtu Komisioni gjykon, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që në momentin e zhvillimit të procedurës, të sigurohet, që operatori ekonomik, i cili do të shpallet fitues, të ketë të gjitha kapacitetet e nevojshme teknike dhe profesionale për përmbushjen me sukses të kontratës ndaj edhe Kriteri 2.3.3 për disponimin prej minimalisht 5 personave.... **pa specifikuar 2 shoferë qëndron.**

Autoriteti kontraktor të heqë kërkesën specifike për 2 shoferë nga Procesverbali, për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për Kriterin 2.3.3.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë pjesërisht.

III.9. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Erisoni Company” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket Kriterëve 2.4.2. dhe 2.4.4. për të cilët ankimesi pretendon të hiqen nga shtojca 9, e DST, [*... si kritere diskriminuesë dhe që nuk kanë lidhje me objektin e prokurimi...*],

Komisioni gjykon të mos të trajtojë pretendimet e operatorit ekonomik përsa kohë në lidhje me këto kritere ka arsyetuar në pikat III.3.1 e në vazhdim dhe III.4 e në vazhdim, ku ka vendosur t’i heqë ato kritere nga shtojca 9 e DST.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

III.10. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Erisoni Company” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt – ankimi.

Për sa i përket Operatori ekonomik duhet të përgjigjet brenda 4 (katër) orëve për defektet e pajisjeve. Në rastin kur pajisja nuk riparohet brenda 4 (katër) orëve, pajisja duhet të zëvendësohet brenda 24 orëve. Pajisjet duhet të funksionojnë 24 orë.

E kundërshtojmë këtë kriter, tepër i ekzagjeruar, është në kundërshtim me nenin 2 dhe 3 të LPP dhe nenin 77.

Kërkojmë modifikim të kriterit.

III.10.1. Autoriteti Kontraktor ka publikuar në SPE në Shtojcën 8, (*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*).

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

- Në çmimin e dhënë përfshihet Letra A3/A4. Duhet të përfshihen pajisjet (31 pajisje A4 & A3 bardhe zi dhe color), të gjithë tonerat e nevojshëm deri në përfundim të kontratës, së mjaftueshme për printime deri në përfundimin e kontratës, drumet dhe çdo pjesë këmbimi tjetër për mirëfunksionimin e pajisjeve.
- Të gjithë tonerat duhet të jenë origjinale të llojit të printerit ose ekuivalent me të dhe të qëndrojnë stok në magazinën e institucionit. Të paktën një toner rezervë për çdo tip pajisje funksionale, duhet të jetë prezent në magazinën e institucionit.
- **Operatori ekonomik duhet të përgjigjet brenda 4 (katër) orëve për difektet e pajisjeve. Në rastin kur pajisja nuk riparohet brenda 4 (katër) orëve, pajisja duhet të zëvendësohet brenda 24 orëve.**

- Koha e Shërbimit do të jetë për 12 muaj.
- Pajisjet do të vendosen në ambjentet e UK Durrës, UK Kavajë, UK Krujë, UK Shijak, UK Rrogozhinë.
- Pajisjet duhet të funksionojnë 24 orë.
- Pajisjet duhet të funksionojnë si printer, fotokopje dhe skaner për të gjithë përdoruesit e mundshëm, duke u lidhur me rrjetin ekzistues të UK Durrës, UK Kavajë, UK Krujë, UK Shijak, UK Rrogozhinë.

Shpërndarja: SHRUKD

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: SHRUKD

III.10.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim dhe kërkesat në një procedurë prokurimi vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit

Komisioni thekson faktin se në hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit autoriteti duhet t'i argumentojë ato në proporcion me natyrën e procedurës së prokurimit, rëndësinë që ka shërbimi i kërkuar për autoritetin kontraktor dhe në këtë kontekst Ak ka përcaktuar:

Termat e Referencës dhe konkretisht kërkesën objekt ankimi - *Operatori ekonomik duhet të përgjigjet brenda 4 (katër) orëve për difektet e pajisjeve. Në rastin kur pajisja nuk riparohet brenda 4 (katër) orëve, pajisja duhet të zëvendësohet brenda 24 orëve.*

Komisioni, referuar ankesës në lidhje me këtë pretendim, konstaton se Operatori nuk ka argumentuar drejt dhe saktë se përse e kundërshton këtë kërkesë dhe çfarë kërkon konkretisht të modifikojë.

Në analizë të dokumenteve të dosjes administrative, Komisioni gjykon se operatori ekonomik nuk ka argumentuar saktë pretendimet në lidhje me ankesën duke rezultuar konfuz në kërkesat e tij.

Në lidhje me vendosjen e kërkesës objekt ankimi, Komisioni gjykon se kërkesa është e drejtë në proporcion me elementet e procedurës së prokurimit dhe me rëndësinë që kjo procedurë ka për AK-në, që është vijimësia e proceseve të punës për sektorë të rëndësishëm të autoritetit dhe zgjidhjen e defekteve në kohë sa më të shpejtë të mundur.

Pretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndrojnë.

III.11. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Erisoni Company” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket Specifikimeve teknike për pajisjet si vijon:

Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A3

Në karakteristikat e përcaktuara nga AKSHI për të gjitha pajisjet fotokopje dhe printera për asnjërin prej këtyre pajisjeve nuk janë përcaktuar fare kërkesat teknike, në lidhje me **Dimensionet e ekraneve,**

Dimensione të pajisjeve. Të hiqen

Kundërshtojmë edhe keto specifikime teknike për:

16 Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A3

Përmasat dhe parametra:

Pasi janë të ekzagjeruara dhe jo në përputhje me volumin e kontratës.

Rezolucioni i Printimit	≥1200x1200
Memoria	≥ 2 GB
Kapaciteti në Hyrje Input Capacity	≥1200 fletë
Kapaciteti mbajtes se ADF	≥150 fletë
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity:	≥500 fletë

Të modifikohen pasi janë shumë të larta.

23 Fotokopje/Printer/Skaner(Bardh/Zi) A4 për volume te larta pune

Përmasat dhe parametrat sipas AKSHI-it

Shpejtësia 55 copy/minutë është tepër e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me volumin e kontratës. Te shikohen dimensionet nuk janë në specifikimet e AKSHIT.

Kërkojmë që shpejtësia të jetë **35-40 copy në minutë.**

Rezolucioni i Printimit	≥ 1200x1200
Memoria	≥ 2 GB
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity”	≥650 fletë
Kapaciteti mbajtes se ADF	≥150 fletë
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity“:	≥550 fletë

5 Fotokopje/Printer/Skaner(Bardh/Zi) A4 për volume të mesme

Shpejtësia Kopje/Print per A4	≥ 40 ppm
Rezolucioni i Printimit	≥ 1200x1200
Memoria	≥ 2 GB
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity”	≥250 fletë
Kapaciteti mbajtes se ADF	≥50 fletë
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity:	≥100 fletë
Ekrani	7 inch.

Kërkojmë modifikimin e këtyre kriterëve pasi edhe vetë AK nuk e ka argumentuar qartë në procesverbal.

Kundërshtojmë dimensionet e pajisjeve, dhe këto specifikime, teknike të jenë sipas AKSHI-it.

2. Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A4 për volume të mesme pune

Ju lutem na sqaroni, sipër është shënuar Fotokopje/Printer/Skaner (me ngjyra) A4 për volume të mesme pune, kurse te funksioni kërkon, Fotokopje/printer/skaner Bardh e zi.

Çfarë kërkon A4 color apo A4 black and white?

Funksioni:	Fotokopje/printer/skaner Bardh e zi
Shpejtësia “Kopje/Print per A4	≥ 30 ppm
Rezolucioni I Printimit	≥ 1200x1200
Memoria	≥ 2 GB
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity”	≥250 fletë
Kapaciteti mbajtes se ADF	≥50 fletë
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity”:	≥100 fletë

Specifikimet më sipër për A4 janë tepër të ekzagjeruara dhe nuk janë në përputhje me volumin e kontratës që prokurohet. Të bëhen modifikimet për këto specifikime, pasi edhe vetë AK nuk e ka argumentuar qartë në procesverbal.

Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A4 për volum të ulët pune

Pra, Dimesionet e përcaktuara pajisjes W, D dhe H të ndërthuruara edhe me përmasat e kërkuara për ekranin, përjashtojnë të gjitha pajisjet e prodhuesve të tjerë .

Sipër është shkruar:

Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A4

Te funksioni është: **Fotokopje/printer/skaner Bardh e zi.**

Ju lutem na sqaroni çfarë kërkon **A4 color** apo **A4 black and white**.

Kundërshtojmë specifikimet teknike si më poshtë, pasi janë të ekzagjeruar jo në përputhje me volumin e kontratës që prokurohet.

“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner Bardh e zi
Shpejtësia “Kopje/Print për A4	≥ 30 ppm
Rezolucioni i Printimit	≥ 1200x1200

Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A4 për volume të larta pune

- Sipër është shkruar Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A4 për volume të larta pune

Te funksioni është Fotokopje/printer/skaner Bardh e zi.

Ju lutem na sqaroni çfarë kërkon, **A4 color** apo **A4 black and white**?

Shpejtësia 50 ppm është tepër e ekzagjeruar, jo në përputhje me volumin e kontratës që prokurohet.

Rezolucioni i printimit tepër i lartë.

Kërkojmë modifikim të shpejtësisë dhe rezolucionit të printimit. Sipas AKSHI-t, si edhe dimensionet për ekranet.

Pra, Dimesionet e përcaktuara pajisjes . W,D dhe H, të ndërthuruara edhe me përmasat e kërkuara për ekranin, përjashtojnë të gjitha pajisjet e prodhuesve të tjerë . Të hiqen këto specifikime.

Kundërshtojmë specifikimet teknike.

Memoria	≥ 2 GB
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity”	≥650 fletë
Kapaciteti mbajtes se ADF	≥100 fletë
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity “	≥300 fletë

Këto specifikime janë tepër të ekzagjeruara, pasi nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

Kërkojmë modifikimin e këtyre kriterëve.

III.11.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE shtojcwn 6. Formulari i Specifikimeve teknike: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a, për të realizuar shërbimin e printimit, fotokopjimit, skanimit kërkon këto pajisje sipas specifikimeve të poshtë përmendura:

Nr.	Përshkrimi	Nj/M	Sasia
1	Fotokopje/Printer/Skaner (me ngjyra) A3	copë	16
2	Fotokopje/Printer/Skaner (Bardh/Zi) A4 për volume të larta pune	copë	23
3	Fotokopje/Printer/Skaner (Bardh/Zi) A4 për volume të mesme pune	copë	5
4	Fotokopje/Printer/Skaner (me ngjyra) A4 për volume të larta pune		2
	Fotokopje/Printer/Skaner (me ngjyra) A4 për volume të mesme pune	copë	2
	Fotokopje/Printer/Skaner (me ngjyra) A4 për volume të ulët pune	copë	2
	Totali pajisjeve		50
	Software për leximin, manaxhimin, raportimin sipas userave apo departamenteve në lidhje me faqet e printuara, fotokopjuara		1

Specifikime teknike të pajisjeve të kërkuara:

● **16 Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A3.**

“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner me ngjyra
Shpejtësia “Kopje/Print per A4	≥45 ppm
Rezolucioni i Printimit	≥1200x1200
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”:	SPDF/DADF
Dimesionet standarte ne mm (WxDxH)	≤ 590 x 685 x 965 mm
Ekrani	≥ 7 inch, colour touch screen
Kopjim/printim në të dy faqet “Duplex copying/print.”:	Po
Formati i letrës “Media sizes”:	A3, A4
Memoria	≥ 2 GB
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity”	≥1200 fletë
Kapaciteti mbajtes se ADF	≥150 fletë
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity”:	≥500 fletë

● **23 Fotokopje/Printer/Skaner(Bardh/Zi) A4 për volume të larta pune.**

“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner Bardh e zi
Shpejtësia “Kopje/Print per A4	≥55 ppm
Rezolucioni i Printimit	≥ 1200x1200
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”:	SPDF/DADF
Dimesionet standarte ne mm (WxDxH)	≤550 x 580 x 730 mm

Ekrani	≥7 inch, colour touch screen
Kopjim/printim në të dy faqet “Duplex copying/print.”:	Po
Formati i letrës “Media sizes”:	A4
Memoria	≥ 2 GB
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity”	≥650 fletë
Kapaciteti mbajtes se ADF	≥150 fletë
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity”:	≥550 fletë

● **5 Fotokopje/Printer/Skaner(Bardh/Zi) A4 për volume të mesme.**

“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner Bardh e zi
Shpejtësia “Kopje/Print per A4	≥ 40 ppm
Rezolucioni i Printimit	≥ 1200x1200
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”:	SPDF/DADF
Dimesionet standarte ne mm (WxDxH)	≤490 x 480 x 545 mm
Ekrani	≥7 inch, colour touch screen
Kopjim/printim në të dy faqet “Duplex copying/print.”:	Po
Formati i letrës “Media sizes”:	A4
Memoria	≥ 2 GB
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity”	≥650 fletë
Kapaciteti mbajtes se ADF	≥100 fletë
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity”:	≥250 fletë

● **2 Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A4 për volume të mesme pune.**

“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner Bardh e zi
Shpejtësia “Kopje/Print per A4	≥ 30 ppm
Rezolucioni i Printimit	≥ 1200x1200
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”:	SPDF/DADF
Dimesionet standarte ne mm (WxDxH)	≤ 500 x 565 x 510 mm
Ekrani	≥7 inch, colour touch screen
Kopjim/printim në të dy faqet “Duplex copying/print.”:	Po
Formati i letrës “Media sizes”:	A4
Memoria	≥ 2 GB
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity”	≥250 fletë
Kapaciteti mbajtes se ADF	≥50 fletë
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity”:	≥100 fletë

● **2 Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A4 për volume të ulët pune.**

“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner Bardh e zi
Shpejtësia “Kopje/Print per A4	≥ 30 ppm
Rezolucioni i Printimit	≥ 1200x1200
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”:	ADF
Dimesionet standarte ne mm (WxDxH)	≤ 466 x 404 x 251 mm
Ekrani	≥4.3 inch, colour touch screen
Kopjim/printim në të dy faqet “Duplex copying/print.”:	Po
Formati i letrës “Media sizes”:	A4
Memoria	≥ 256MB
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity”	≥150 fletë
Kapaciteti mbajtes se ADF	≥50 fletë
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity”:	≥50 fletë

● **2 Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A4 për volume të larta pune.**

“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner Bardh e zi
Shpejtësia “Kopje/Print per A4	≥ 50 ppm
Rezolucioni i Printimit	≥ 1200x1200
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”:	SPDF/DADF
Dimesionet standarte ne mm (WxDxH)	≤ 480 x 535 x 625 mm
Ekrani	≥7 inch, colour touch screen
Kopjim/printim në të dy faqet “Duplex copying/print.”:	Po
Formati i letrës “Media sizes”:	A4
Memoria	≥ 2 GB
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity”	≥650 fletë
Kapaciteti mbajtes se ADF	≥100 fletë
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity “:	≥300 fletë

Sqarimi mbi specifikimet teknike te pajisjeve:

“Specifikimet teknike janë ndërtuar në përputhje me standardet e rekomanduara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), me qëllim që të sigurohet ndërveprueshmëri, siguri dhe përputhshmëri me sistemet ekzistuese të administratës publike”.

● **1 Softwer për menaxhimin e pajisjeve.**

	<u>Specifikimet e Software</u>
1	Monitorim i plotë i të gjitha dokumenteve të printuara në rrjet.
2	Politika të personalizuar printimi (p.sh. blloko printimet në ngjyra, ridrejto dokumentet në printerë më efikas).
3	Quota për përdorues / grupe (sasi ose vlerë monetare).
4	Rregulla automatike për kursim – si: <i>duplex by default, konvertim në B/W</i> , etj.
5	Secure Print Release – përdoruesit duhet të autentifikohen për të lëshuar dokumentin nga printeri.
6	Find-Me Printing – dokumenti mund të merret nga çdo printer në rrjet.

7	Auditim i detajuar për çdo veprim të përdoruesve (kush printoi, çfarë, kur, sa faqe).
8	Mobility Print – për Windows, macOS, iOS, Android dhe Chromebook.
9	Web Print – printim pa instaluar driver (thjesht ngarkon dokumentin në web).
10	Email to Print – dërgo dokumentin me email në printer.
11	Raportim & Analiza Mbi 80 raporte të gatshme për përdorues, utomat, kosto, sjellje, etj./ Eksportim në PDF, CSV dhe planifikim utomatic i dërgimit me email.

III.11.2. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në 13 zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

Neni 36, “Specifikimet teknike” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve

ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.

III.11.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së Lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, thuhet se: Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë, që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, të ushtrojnë të drejtën e ankimimit mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110, pika 1 të ligjit.

III.11.4. Komisioni i Prokurimit Publik referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues, mori në shqyrtim dokumentacionin e tenderit, shtojcën 6, specifikimet teknike të publikuar në SPE si edhe vendimin e KSHA-së me anë të së cilës AK nuk ka pranuar këto pretendime të operatorit ekonomik.

Komisioni thekson se autoriteti kontraktor, në hartimin e specifikimeve teknike, duhet të evitojë përcaktimet dhe parametra me vlera fikse ose shumë të larta, në lidhje me funksionet e pajisjeve të sipërcituara, në mënyrë që të mos ketë asnjë element që çon në kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Komisioni, në analizë të dokumenteve të dosjes vëren, se AK, në specifikimet teknike, ka përcaktuar parametra objekt ankimi duke vendosur vlera të larta, çka ka sjellë ankesë në lidhje me ato. Komisioni gjykon se ankimuesi me të drejtë ngre pretendime mbi modifikime të parametrave në lidhje me përmasat e pajisjeve, përmasat e ekraneve dhe parametrat e tjera mbi funksionet e pajisjeve dhe sugjeron që ato të jenë në referim të specifikimeve të AKSHI-it. Gjithashtu, ankimuesi ka qenë i vëmendshëm në konstatime të emërtimeve të pajisjeve, ku ka vërejtur pasaktësi, sugjeruar në ankesën e tij.

Komisioni, referuar specifikimeve teknike si edhe pretendimet e ngritura në ankesë, gjykon se Autoriteti kontraktor përse i përket parametrave të përcaktuara në lidhje me pajisjet e printimit, duhet t'i rishikojë sipas **parametrave** orientuese të përcaktuara në manualin e specifikimeve teknike të publikuara nga AKSHI, përse kohë AK është shprehur në Shtojcë se “*Specifikimet teknike janë ndërtuar në përputhje me standardet e rekomanduara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), me qëllim që të sigurohet ndërveprueshmëri, siguri dhe përputhshmëri me sistemet ekzistuese të administratës publike*” si edhe me synimin për të hapur mundësinë e ofertimit nga operatorët ekonomikë në kuadër të një pjesëmarrjeje të gjerë dhe konkurrese në këtë procedurë.

Përse më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Rikon-AL” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-60680-09-09-2025, me objekt “Shërbim i Printimit dhe Fotokopjimit” me fond limit: 7,000,000 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor Shoqërisa Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sh.A.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Rikon-AL” SHPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Erisoni Company” SHPK për procedurën e prokurimit prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-60680-09-09-2025, me objekt “Shërbim i Printimit dhe Fotokopjimit” me fond limit: 7,000,000 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor Shoqërisa Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sh.A.
4. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Rikon-AL” SHPK dhe “Erisoni Company” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

